Referuar nenit 84 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore zhvillohet në media sipas kushteve dhe kritereve parashikuara në ligj.

Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021, i Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, përcakton detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të verifikuar dhe kontrolluar respektimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore.

Pikat 5 dhe 6 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor normojnë kohën e lejuar të transmetimit të “reklamave politike” gjatë fushatës zgjedhore. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës.

Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. KQZ-ja i publikon tarifat në faqen zyrtare të internetit.

Referuar pikës 6 të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës prej jo më shumë se 90 minuta ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi tarifat zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të, raportet financiare të dorëzuara nga vetë partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, raportet e audituesve ligjorë, si dhe raportet e dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). AMA monitoroi OSHMA-të për transmetimin e reklamave politike për periudhën 26 mars 2021 - 23 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme janë të ilustruara përlllogaritjet lidhur me vlerën e deklaruar nga vetë subjektet zgjedhore përkthyer në minuta si dhe minutat e raportuara nga AMA përlllogaritur në vlerë monetare, nga ku rezulton se:

- Partia Socialiste e Shqipërisë ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlllogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Report Tv	26	201	175
Klan News	0	290	290
Euronews Albania	10	152	142
Vizion Plus	38	199	161
News 24	39	213	174
Abc News	75	176	101
Top News	0	244	244

Top Channel	91,41	288	197
MCN	0	10	10
Klan TV	44,52	301	257
Klan Plus	0	260	260
RTV Ora	0	49	49
FAX News	0	43	43

- Partia Demokratike ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Klan News	0	228	228
Euronews Albania	4,35	114	109.65
Vizion Plus	12,24	31	19
News 24	8,42	127	119
Abc News	31,08	135	104
A2 CNN	0	97	97
Top Channel	47	176	129
MCN	0	4	4
Klan TV	13,71	259	245
Klan Plus	0	284	284
RTV Ora	8,80	141	132
FAX News	6,32	176	170

Ora News	0	2	2
----------	---	---	---

- Partia Socialdemokrate ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Klan News	0	24	24

- Partia Bindja Demokratike ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Report Tv	0	43	43
Euronews Albania	0	4	4
Vizion Plus	3,67	19	15
A2 CNN	0	50	50
Klan TV	2,89	14	11
Ora News	0	5	5

- Nisma Thurje ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Report TV	0	71	71
Top News	0	11	11

- Lëvizja Socialiste për Integrim ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Report TV	0	21	21
Euronews Albania	0	13	13
Fax News	0	41	41
News 24	0	6	6
Top News	0	15	15
Abc News	0	10	10
RTV Ora	0	46	46

- Lëvizja për Ndryshim ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Report TV	0	64	64
Klan TV	0	3	3
Vizion Plus	0	12	12

- Partia Kombëtare Konservatore Albania ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetim reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Top News	0	18	18

Nga përlogaritjet e minutave vihet re se:

3. Ka diferenca për disa parti politike, midis deklarimit të bërë për reklamë politike në raportin financiar dhe minutave të transmetuara, përlogaritur nga KQZ-ja.
4. Disa OSHMA nuk kanë respektuar detyrimin e kohës së përgjithshme të transmetimit të reklamave politike, e cila nuk duhet të kalojë me shumë se 90 minuta gjatë gjithë fushatës zgjedhore.
5. Nuk është respektuar detyrimi ligjor për ofrimin e gjysmës së kohës falas nga 2 OSHMA. Përkatësisht, ABC News për Partinë Socialiste të Shqipërisë dhe Top Channel për Partinë Socialiste të Shqipërisë si dhe Partinë Demokratike.

Partitë politike kanë raportuar shpenzimet për reklama politike në vlerë monetare. Tarifat zyrtare të dorëzuara nga disa OSHMA janë në vlerë monetare për minutë ose sekond. Raportet e vëna në dispozicion nga AMA janë në minuta. Gjatë përlllogaritjes në minuta të transmetimit të reklamave, është bërë edhe përlllogaritje e diferencës në vlerë monetare midis të dhënave të raportuara.

Bazuar në llogaritjet e mësipërme rezulton se ka diferenca në deklarime. Këto diferenca konvertohen në vlera monetare, si vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë:
 - Televizionit Kombëtar Klan vlerën 73.251.914 lekë
 - VII. Televizionit Report TV vlerën 34.870.500 lekë;
 - VIII. Televizionit Klan News vlerën 20.880.000 lekë
 - IX. Televizionit Euronews Albania vlerën 42.600.000 lekë
 - X. Televizionit Vizion Plus vlerën 17.146.500 lekë
 - XI. Televizionit News 24 vlerën 26.966.520 lekë;
 - XII. Televizionit Abc News vlerën 4.242.000 lekë;
 - XIII. Televizionit Top News vlerën 3.601.440 lekë;
 - XIV. Televizionit Top Channel vlerën 25.808.640 lekë;
 - XV. Televizionit Klan Plus vlerën 19.344.000 lekë;
 - XVI. Televizionit RTV Ora vlerën 7.232.400 lekë;
 - XVII. Televizionit Fax News vlerën 4.442.760 lekë;
 - XVIII. Televizioni MCN vlerën 516.600 lekë.

- Partia Demokratike:
 - 9. Televizionit Fax News vlerën 17.531.678 lekë;
 - 10. Televizionit Abc News vlerën 4.364.716 lekë;
 - 11. Televizionit Euronews Albania vlerën 32.894.822 lekë;
 - 12. Televizionit News 24 vlerën 18.377.600 lekë;
 - 13. Televizionit A2 CNN vlerën 5.011.020 lekë;

14. Televizionit Klan TV vlerën 70.056.138 lekë;
 15. Televizionit Top Channel vlerën 16.956.781 lekë;
 16. Televizionit Ora News vlerën 221.400 lekë
 17. Televizionit MCN vlerën 206.640 lekë
 18. Televizionit RTV Ora vlerën 19.512.941 lekë
 19. Televizionit Klan Plus vlerën 21.129.600 lekë;
 20. Televizionit Klan News vlerën 16.416.000 lekë;
 21. Televizionit Vizion Plus vlerën 1.997.700 lekë.
- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim:
 - i. Televizionit Report TV vlerën 4.184.460 lekë;
 - ii. Televizionit Euronews Albania vlerën 3.900.000 lekë;
 - iii. Televizionit Fax News vlerën 4.236.120 lekë;
 - iv. Televizionit News 24 vlerën 929.880 lekë;
 - v. Televizionit Top News vlerën 221.400 lekë;
 - vi. Televizionit Abc News vlerën 420.000 lekë
 - vii. Televizionit RTV Ora vlerën 6.789.600 lekë
 - Partia Bindja Demokratike:
 6. Televizionit Report TV vlerën 8.568.180 lekë
 7. Televizionit A2 CNN vlerën 2.583.000 lekë
 8. Televizionit Euronews ALbania vlerën 1.200.00 lekë
 9. Televizionit Klan TV vlerën 3.174.400 lekë
 10. Televizionit Ora News vlerën 553.500 lekë
 11. Televizionit Vizion Plus vlerën 1.632.360 lekë
 - Partia Lëvizja për Ndryshim:
 - a. Televizionit Vizion Plus vlerën 1.278.000 lekë
 - b. Televizionit Klan TV vlerën 856.800 lekë
 - c. Televizionit Report TV vlerën 12.752.640 lekë

- Partia Nisma Thurje:
 1. Televizionit Report TV vlerën 14.147.460 lekë
 1. Televizionit Top News vlerën 162.360 lekë

- Partia Kombëtare Konservatore Albania:
 - Televizionit Top News vlerën 265.680 lekë

- Partia Social Demokrate:
 1. Televizionit Top Channel vlerën 3.150.720 lekë

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e të gjitha të dhënave të sipërcituara.

Përlogaritja e shpenzime të fushatës zgjedhore në media, për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021							
Subjektet zgjedhore	OSHMA-të	Çmimi sipas mesatares të përlogaritur nga tarifat e dorëzuara/min	Vlera e raportuar nga partia/lekë	Minutat e përlogaritura nga vlerat e raportuara nga partia	Raporti AMA/min	Vlera e përlogaritur nga minutat e raportuara nga AMA	Diferenca e përlogaritur nga minutat e raportuara nga AMA me vlerën e raportuar nga partia /lekë
PS	Report TV	199.260	5.180.760	26	201	40.051.260	34.870.500
	Klan News	72.000	-	-	290	20.880.000	20.880.000
	Euronews Albania	300.000	3.000.000	10	152	45.600.000	42.600.000
	Vizion Plus	106.500	4.047.000	38	199	21.193.500	17.146.500
	News 24	154.980	6.044.220	39	213	33.010.740	26.966.520
	Abc News	42.000	3.150.000	75	176	7.392.000	4.242.000
	Top News	14.760	-	-	244	3.601.440	3.601.440
	Top Channel	131.280	12.000.000	91,41	288	37.808.640	25.808.640
	MCN	51.660	-	-	10	516.600	516.600
	Klan TV	285.600	12.713.686	44,52	301	85.965.600	73.251.914
Klan Plus	74.400	-	-	260	19.344.000	19.344.000	
RTV Ora	147.600	-	-	49	7.232.400	7.232.400	
Fax News	103.320	-	-	43	4.442.760	4.442.760	
PD	Fax News	103.320	652.642	6,32	176	18.184.320	17.531.678
	Abc News	42.000	1.305.284	31,08	135	5.670.000	4.364.716
	Euronews Albania	300.000	1.305.178	4,35	114	34.200.000	32.894.822
	News 24	154.980	1.304.860	8,42	127	19.682.460	18.377.600
	A2 CNN	51.660	-	-	97	5.011.020	5.011.020
	Klan TV	285.600	3.914.262	13,71	259	73.970.400	70.056.138
	Top Channel	131.280	6.148.499	47	176	23.105.280	16.956.781
	Ora News	110.700	-	-	2	221.400	221.400
	MCN	51.660	-	-	4	206.640	206.640
	RTV Ora	147.600	1.298.659	8,80	141	20.811.600	19.512.941
Klan Plus	74.400	-	-	284	21.129.600	21.129.600	
Klan News	72.000	-	-	228	16.416.000	16.416.000	
Vizion Plus	106.500	1.303.800	12,24	31	3.301.500	1.997.700	
LSI	Report TV	199.260	-	-	21	4.184.460	4.184.460
	Euronews Albania	300.000	-	-	13	3.900.000	3.900.000
	Fax News	103.320	-	-	41	4.236.120	4.236.120
	News 24	154.980	-	-	6	929.880	929.880
	Top News	14.760	-	-	15	221.400	221.400
	Abc News	42.000	-	-	10	420.000	420.000
	RTV Ora	147.600	-	-	46	6.789.600	6.789.600
BD	Report TV	199.260	-	-	43	8.568.180	8.568.180
	A2 CNN	51.660	-	-	50	2.583.000	2.583.000
	Euronews Albania	300.000	-	-	4	1.200.000	1.200.000
	Klan TV	285.600	824.000	2,89	14	3.998.400	3.174.400
	Ora News	110.700	-	-	5	553.500	553.500
	Vizion Plus	106.500	391.140	3,67	19	2.023.500	1.632.360
LN	Report TV	199.260	-	-	64	12.752.640	12.752.640
	Klan Tv	285.600	-	-	3	856.800	856.800
	Vizion Plus	106.500	-	-	12	1.278.000	1.278.000
NTH	Report TV	199.260	-	-	71	14.147.460	14.147.460
	Top News	14.760	-	-	11	162.360	162.360
PKKA	Top News	14.760	-	-	18	265.680	265.680
PSD	Top Channel	131.280	-	-	24	3.150.720	3.150.720

V.2 Verifikimi i mëtejshëm me partitë politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në muajin Dhjetor 2021, u kërkoi partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, shpjegime mbi shpenzimet për reklamat në media dhe mbi kontratat që këto parti politike kanë lidhur me mediat. Shkresa iu drejtua partive politike që kanë përfituar fonde nga Buxheti i Shtetit, duke qenë se përbënin dhe vlerat me diferencë më të madhe, si më poshtë

vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
2. Partia Demokratike;
3. Partia Socialdemokrate;
4. Partia Bindja Demokratike;
5. Nisma Thurje;
6. Lëvizja Socialiste për Integrim.

Subjekti zgjedhor “**Partia Socialiste e Shqipërisë**” i është përgjigjur kërkesës duke dorëzuar kontratën e lidhur me OSHMA-të, si dhe një shkresë ku shpjegon se të gjitha shpenzimet e kryera janë deklaruar.

Subjekti zgjedhor “**Lëvizja Socialiste për Integrim**” ka kthyer përgjigje duke na vënë në dispozicion korrespondencën me anë të email-it me disa prej OSHMA-ve ku shprehet se nuk ka marrëdhënie kontraktuale dhe gjithashtu shpenzimet e kryera nga ky subjekt janë deklaruar.

Subjekti zgjedhor “**Partia Bindja Demokratike**” ka kthyer përgjigje duke na vënë në dijeni se ka kontratë vetëm me 3 (tre) televizione dhe se shpenzimet e kryera janë vetëm ato të deklaruara në raportin e dorëzuar. Kontratat e lidhura midis subjektit dhe televizioneve nuk janë dorëzuar.

Subjekti zgjedhor “**Nisma Thurje**” në kthimin e përgjigjes deklaron se shpenzimet e kryera janë ato të deklaruara, dhe nuk ka pasur shpenzime të tjera. Nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me OSHMA - të.

Subjekti zgjedhor “**Partia Socialdemokrate**” në kthimin e përgjigjes deklaron se nuk ka kryer asnjë shpenzim tjetër përveç asaj që ka deklaruar në raportin e dorëzuar. Gjithashtu deklaron se nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet subjektit zgjedhor PSD dhe OSHMA - ve.

Nga përgjigjet e marra nga partitë politike justifikohen vetëm vlerat e deklaruara në raportet e dorëzuara nga vetë subjektet dhe audituesit.

Subjekti zgjedhor “**Partia Demokratike**” nuk ka kthyer përgjigje.

Moskthimi i përgjigjes nga ana e “Partisë Demokratike” është në kundërshtim me nenin 92/6, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon se “...KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji...”

Bazuar nenit 173, pika 8, i Kodit Zgjedhor, mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë.

V.3 Verifikimi i mëtejshëm me OSHMA-të (media)

Pas kthimit të përgjigjes nga ana e subjekteve zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u është drejtuar me shpresë, në muajin Janar 2022, atyre televizioneve që kanë dorëzuar tarifa zyrtare sipas nenit 84, pika 5, të Kodit Zgjedhor, lidhur me mospërputhjet e evidentuara si dhe ka kërkuar informacion lidhur me kontratat që kanë lidhur me partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar OSHMA-ve si vijon:

- Televizionit **Report Tv** me shpresë me nr. Prot. 46, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Social Demokrate, Partia Nisma Thurje, Partia Bindja

Demokratike si dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

- Televizionit **ABC News** me shkresë me nr. Prot. 54, datë 13.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **Vizion Plus** me shkresë me nr. Prot. 44, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike, si dhe Partia Bindja Demokratike.
- Televizionit **Klan TV** me shkresë me nr. Prot. 47, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë Partia Bindja Demokratike si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **Top Channel** me shkresë me nr. Prot. 43, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia SocialDemokrate si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **Fax News** me shkresë me nr. Prot. 45, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **RTV Ora** me shkresë me nr. Prot. 41, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **EuroNews Albania / Balcan News** me shkresë me nr. Prot. 39, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Bindja Demokratike si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **Klan News** me shkresë me nr. Prot. 40, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe Partia Demokratike.
- Televizionit **Klan Plus** me shkresë me nr. Prot. 42, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe Partia Demokratike.

- Televizionit **Top News** me shkresë me nr. Prot. 48, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe Partia Nisma Thurje.
- Televizionit **News 24** me shkresë me nr. Prot. 38, datë 12.01.2022, ku i kërkohet informacion mbi shpenzimet për reklamat që kanë kryer subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe Partia Demokratike

V.3.1 OSHMA-të të cilat i janë përgjigjur KQZ-së

Në lidhje me diferencat ndërmjet minutave të reklamave politike të transmetuara nga OSHMA-të me minutat e paguara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje (minuta të përlogaritura nga KQZ referuar shumës së deklaruar si shpenzim për reklamë dhe tarifave zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të) OSHMA-të (televizionet) kanë kthyer përgjigjet si vijon:

Televizioni **Report TV** sqaron se mund të ketë ndodhur ndonjë mospërputhje plus/minus me mediaplanin e tyre për gabime njerëzore nga operatori i playout. Në rast se është e nevojshme duhet të rishikohen regjistrimet.

Në përgjigje të shkresës, televizioni **Abc News** ka sqaruar se kjo mospërputhje nuk është gjë tjetër veç një vëzhgim i jashtëm dhe i padetajuar i trajtimit të rezervuar, duke mos marrë në konsideratë gjithashtu uljet në formë bonusi, të cilat iu janë shërbyer subjekteve zgjedhore të interesuara.

Televizioni **Tv Klan** sqaron se vlerat e deklaruara nga partitë politike janë vlera të sakta dhe të vetme të paguara prej tyre për fushatë zgjedhore. Diferencat e konstatuara nga AMA janë teorike, nisur nga tarifat zyrtare. Në praktikën e vetë disavjeçare për të gjitha subjektet tregtare që reklamojnë produktet e tyre aplikon zbritje nga tarifa. Lidhur me kanalet e tjera të platformës së shoqërisë Klan Plus dhe Klan News, sqaron se nuk është aplikuar pagesë, pasi janë kërkuar si bonus nga ana e subjekteve zgjedhore për shkak të audiencës së ulët në treg si dy kanale të sapo krijuara.

Televizioni **EuroNews Albania / Euro Balcan News** sqaron se bazuar në kontratën e ofrim

shërbimit të lidhur midis saj dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” i ka ofruar kohë televizive dhe për shërbimet që ka ofruar është kompensuar financiarisht në datë 22.04.2021, në vlerën 3.000.000 (tre milion) lekë, duke përfshirë vlerën e TVSH-së. Për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, i ka ofruar kohë televizive dhe për shërbimet që ka ofruar është kompensuar financiarisht në datë 14.04.2021 në vlerën 10.600 (dhjetë mijë e gjashtë qind) euro, duke përfshirë vlerën e TVSH –së. Për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”, nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie kontraktore, por për të mos diskriminuar asnjë parti gjatë fushatës zgjedhore i ka ofruar këtij subjekti transmetimin e vetëm 13 minuta kohë televizive.

Televizioni **Fax News** sqaron se nuk ka pasur një marrëdhënie kontraktore me subjektet zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Lëvizja Socialiste për Integrim”. I vetmi subjekt zgjedhor që kanë pasur marrëdhënie kontraktore gjatë procesit zgjedhor është “Partia Demokratike”. Fax News transmetoi spotet gjatë fushatës zgjedhore për të qenë sa më korrekt në minutazhin e dedikuar secilës parti e kërkuar kjo dhe nga institucioni AMA-s. Gjatë fushatës zgjedhore Fax News ka pasur në qëllimin e saj të jetë e drejtë dhe e paanshme në transmetimin e fushatës zgjedhore të çdo subjekti zgjedhor.

Televizioni **Vizion Plus** sqaron se deklarimi i shoqërisë është i njëjtë me deklarin e subjekteve zgjedhore.

Nga sqarimet e dhëna nga televizionet konstatohet se disa prej tyre edhe pse nuk kanë pasur marrëdhënie kontraktore me partitë politike kanë transmetuar “*reklama politike*”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve analizoi raportin e AMA-s, deklarinimet e partive politike për shpenzimet për “*reklama politike*” ne media dhe tarifat zyrtare të dorëzuara nga ana e disa OSHMA-ve. Pas komunikimit në formë shkresore ndërmjet KQZ, partive politike dhe mediave për mospërputhjet e konstatuara ndërmjet kohës së paguar nga ana e subjekteve zgjedhore dhe asaj të transmetuar nga televizionet konstatohet se nuk ka asnjë marrëdhënie tjetër kontraktore ndërmjet OSHMA - ve dhe partive politike përveç atyre të deklaruara nga vetë partitë politike.

Neni 92/1, pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin dhe kategoritë e personave juridikë të cilëve u ndalohet dhënia e fondeve për qëllime të fushatës zgjedhore. Një nga kategoritë e ndaluara

janë personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e medias.

Referuar ndalimit ligjor për median, përcaktohet vetëm ndalimi për dhënien e fondeve për fushatën zgjedhore për partitë politike duke mos u shprehur për ndalime të tjera që nuk janë fonde.

Kodi Zgjedhor, në nenin 90 trajton dhurimet si një nga format e të ardhurave në fushatë zgjedhore. Në bazë e për zbatim kë këtij neni, Komisioni Rregullator ka miratuar vendim nr. 10, datë 24.12.2020, “Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituara nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore”.

Dhurimet mund të jenë në formë monetare ose dhurime në natyrë në formë mallrash/produktesh dhe shërbimesh të ofruara pa pagesë ose me një çmim më të ulët se ai i tregut, huatë dhe kreditë me përqindje më të ulët se norma e interesit të tregut ose pa normë interesi. Pika 2 e vendimit nr. 10/2020 parashikon që vlera monetare e dhurimit vërtetohet nga dokumentacioni i mbajtur nga përfituesi dhe dhuruesi në momentin e dhurimit.

Duke analizuar këto dispozita ligjore, për të vërtetuar dhurimin, kërkohet që të ekzistojë një marrëdhënie juridike ndërmjet palëve ku të shprehet vullneti i përbashkët, nga njëra anë e dhuruesit për llojin e dhurimit dhe nga ana tjetër e pranuesit të dhurimit. Vetë Kodi Civil në nenet 761 e vijues, thekson se dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon.

Në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, Vendimit nr.10/2020 të Komisionit Rregullator, si dhe nga hetimi i kryer nuk u provua shprehja e vullnetit nga ana e partive politike për të pranuar reklama politike përveç atyre të përcaktuara në kontratat që kanë vënë në dispozicion të KQZ-së.

Nga ana tjetër vërtet Kodi Zgjedhor ka parashikuar si ndalim dhurimin e fondeve nga ana e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e mediave, por në këtë rast nuk ka përcaktuar çfarë sanksionesh ka si për dhuruesit (median), po ashtu edhe për pranuesit e dhurimit (subjektin zgjedhor). Për dhuruesit jo media, Kodi ka parashikuar sanksion si për këtë kategori dhuruesish (jo media), po ashtu edhe për subjektet zgjedhore si pranues të dhurimit.

V.3.2 OSHMA-të që nuk i janë përgjigjur KQZ-së

Në lidhje me diferencat ndërmjet minutave të reklamave politike të transmetuara nga OSHMA-të me minutat e paguara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje (minuta të përlogaritura nga KQZ referuar shumës së deklaruar si shpenzim për reklamë dhe tarifave zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të) nuk kanë kthyer përgjigje OSHMA-të (televizionet) si vijon:

- Top Channel,
- 1. Top News,
- RTV Ora,
- News 24

OSHMA-të që nuk kanë kthyer përgjigje kërkesës së KQZ janë në kundërshtim me nenin 92/6, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar i cili parashikon: *“...KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji...”*. Sipas nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor, *“...mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë...”*.

VI. Respektimi i minutazhit për reklama politike

VI.1 Tejkalmi i minutazhit nga radio dhe televizione private.

Neni 84, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore e cila nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. Nga raportet e administruara rezulton se televizionet që kanë kaluar minutazhin e lejuar janë:

- One TV Ora
- Report TV
- Klan News
- Shijak TV
- 6+1 Vlora
- A2 CNN
- Syri TV
- Euronews Albania
- Fax News
- Klan TV
- News 24
- Vizion Plus
- Top News
- ABC News
- TV 1 Channel
- Re-Al
- RTV Ora
- Top Channel
- One TV Vlora
- Klan Plus
- TV Best

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat për minutat e transmetuar nga televizionet për ato subjekte zgjedhore ku është tejkaluar koha e përgjithshme e transmetimit të lejuar.

Mosrespektimi i këtij detyrimi ndëshkohet me gjobë sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk bën vepër penale, dënohet me gjobë 3 000 deri 90 000 lekë...”.

- **Dorëzimin e tarifave zyrtare**

Referuar nenit 84, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, “Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifave për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifave publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

OSHMA-të që kanë dorëzuar tarifave zyrtare:

Pranë KQZ-së kanë depozituar tarifave zyrtare OSHMA-të, si më poshtë:

News 24/Balkan web

Top Channel/Top News/TAR

A2 CNN

Klan TV/Klan News

Ora News

Ora TV

ABC News

Vizio Plus

Fax News

Euro News

Report TV

MCN

Klan Plus

OSHMA-të private që nuk kanë dorëzuar tarifat zyrtare:

33 (tridhjetë e tre) OSHMA nuk i kanë dorëzuar tarifat zyrtare. Në vijim paraqitet lista e operatorëve radiotelevizivë që nuk kanë dorëzuar tarifat zyrtare:

- ADTN;
- Digitalb TV;
- ABEG Tv;
- BBF;
- Club Tv;
- Era Digitalb;
- Glob Tv;
- One Tv Vlora;
- Syri Tv;
- Shijak Tv;
- Tv BS;
- Tv 6+1;
- Tv Alpo;
- Tv Antena Nord;
- Tv Apollon;
- Tv Berati;
- Tv Channel 1;

- Tv Channel 7;
- Tv Jug;
- Tv Klaudiana;
- Tv Kopliku;
- Tv Kukësi;
- Tv Lobj;
- Tv Mati;
- Tv Premium Channel;
- Tv Rozafa Motiv;
- Tv Saranda;
- Tv Scan;
- Tv Sot 7;
- Tv Star Plus;
- Tv UTV Education;
- TVT;
- Tv Re.AL

Mosdorëzimi i tarifave zyrtare përbën mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Bazuar në nenin 171, pika 1 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk bën veprë penale, dënohet me gjobë 3 000 deri 90 000 lekë.”.

Konstatime KRIIK.

Pas shtyrjes së vendimit nga Kmissioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e zhvilluar në datë

03.11.2022, KRIIK nëpërmjet email-it dërgoj konstatimet e bëra për Subjektet Zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021, si më poshtë vijon:

- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
- Partia SocialDemokrate;
- Partia Lëvizja për Ndryshim;
- Partia Republikane;
- Partia Lëvizja e Re;
- Partia Nisma Thurje;
- Partia Aleanca Demokracia e Re;
- Partia Lëvizja Demokratike;
- Partia Balli Kombëtar Demokrat;
- Partia Bindja Demokratike;
- Partia Agrare Ambjentaliste;
- Partia Lëvizja e Legalitetit;
- Partia Fryma e Re Demokratike;
- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- Partia Socialiste;
- Partia Demokratike;
- Partia Emigacioni Shqiptar;
- Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- Kandidati i propozuar nga zgjedhësit, z. Elton Debreshi

KQZ pas marrjes së informacionit nga KRIIK, u dërgoi email të gjitha partive politike të sipërcituara.

Nga 19 (nëntëmbëdhjetë) subjekteve zgjedhore, të cilave u dërgua email-i kanë kthyer përgjigje 14 (katërmëdhjetë) subjekte zgjedhore.

Subjektet zgjedhore që kanë kthyer përgjigje;

1. Partia Fryma e Re Demokratike:

Konstatimet KRIIK

- *evidentohet 1 zyrë zgjedhore e padeklaruar;*
- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk ka dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- *ka përmbushur obligimet lidhur me transparencën dhe detyrimet që kanë partitë politike bazuar në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*
- *gjithashtu për periudhën 6 shtator 2020 deri me 25 prill 2021 nuk ka në dispozicion asete si dhe nuk ka detyrime lidhur me këtë çështje.*

2. Partia Bindja Demokratike:

Konstatimet KRIIK

- *evidentohet një numër prej 5 zyrash zgjedhore të padeklaruar;*
- *partia ka deklaruar pranimin e 8 dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti; gjobe – 171 pika 1 ose 172 pika 2b*
- *12 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- *sqaron se ka deklaruar shpenzimet e subjektit dhe jo të kandidatëve. Sipas BD ka qenë një detyrim i kandidatëve nëse kanë pasur zyra dhe subjekti nuk ka pasur dijeni për këto zyra. Sa i përket shpenzimeve në faqet e rrjeteve sociale sqarojnë se i kanë vënë në total duke mos bërë ndarjen subjekt apo kandidat. Dhuratat në shumat monetare nuk janë bërë nëpërmjet bankës pasi dhurimet kanë qenë në shuma më të vogla se 50 mijë lekë dhe dhurimet nuk janë bërë në të njëjtën kohë. Partia deklaroi se në raport shumat e dhuruara nga i njëjti person i kanë mbledhur në një shumë të vetme për efekt lehtësimi, por dhurimi është bërë në kohë të ndryshme*

dhe në shuma më të vogla se 50 mijë lekë.

3. Partia Republikane:

Konstatimet KRIIK

- *partia ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Shpenzimet e kryera gjatë fushatës për Facebook dhe Instagram janë kryer nga Kryetari i partisë dhe njëkohësisht nga kandidati për deputet, z. Fatmir Mediu. Këto shpenzime janë të pasqyruara në raportin financiar të partisë si shpenzime të kandidatit, pasi pagesa është kryer nga karta e tij.
- Shpenzimet e kryera nga kandidati për deputet, z. Ferdinand Çobo, janë të deklaruara në formularin dhe deklaratën e tij.
- Bilanci i aseteve është depozituar në KQZ në datën 5.11.2021

4. Lëvizja për Zhvillim Kombëtar

Konstatimet e KRIIK

- *raporti është dorëzuar në KQZ në tejkalim të afateve ligjore;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- nuk ka pasur ndryshime financiare për periudhën zgjedhore nga ai i bilancit Financiar të vitit 2021, ku janë të përfshira asetet dhe detyrimet.

5. Partia Lëvizja e Legalitetit

Konstatimet e KRIIK

- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e*

ka deklaruar këtë shpenzim;

- *mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Është bërë një pagesë për llogari të Facebook-t në shumën 70\$ për reklamim të faqes personale të z. Shpëtim Axhani, me kartën personale të pagës së tij, nga banka Raiffeisen. Duke qenë se kjo shumë është bërë nga buxheti personal i kandidatit si dhe është në një shumë më të vogël se 10 000 lekë nuk është deklaruar sipas interpretimit që z. Axhani ka arritur ti bëjë Kodit Zgjedhor.
- Bilanci i asetëve është 0 pasi nuk kanë pasur asnjë aset apo detyrim për periudhën 6 shtator 2020 deri me 25 prill 2021.

6. Partia Lëvizja e Re

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 7 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *3 kandidatë kanë deklaruar pranimin e dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *3 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Dhurimet për kandidatët janë shpenzimet që kanë bërë vetë kandidatët për veten e tyre. Totali që kanë bërë gjatë fushatës është mbi 50.000 lekë, por janë pagesa që janë bërë në ditë të ndryshme, të cilat në asnjë rast nuk e kanë kaluar shumën 50.000 lekë.
- Në momentin që partia u informua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që financieri nuk mund të jetë dhe kandidat, ky i fundit ka bërë kërkesën për tërheqje nga kandidimi në datë 13.4.2021.
- Përsa i përket shpenzimeve të kandidatëve për reklamë politike në Facebook dhe Instagram duke qenë se pagesat kanë qenë të pa përfillshme (psh 5 \$, 10 \$) dhe duke

qenë se kandidatët kanë hasur vështirësi për të marrë faturën nga Facebook për këtë arsye nuk e kanë shënuar.

- Bilanci i asetëve është depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me datë 5.11.2021 nr. prot. 6851.
- Përsa i përket 7 zyrave zgjedhore vendet ku janë vendosur logoja e Partisë nuk janë zyra zgjedhore, por janë vende ku është vendosur logoja e partisë nga simpatizant të kandidatëve në ambientet e tyre personale.

7. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 3 zyrash zgjedhore të padeklaruar;*
- *1 kandidat ka deklaruar pranimin e dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Nuk kanë pasur sipërfaqe të okupuara dhe të përdorura si zyra zgjedhore në qendrën e biznesit. Posterat janë vendosur nga simpatizant të partisë
- Lidhur me zyrën zgjedhore në Fushë Krujë, në rrethanat që ato janë ofruar nga kandidati i PAA në këtë zonë zgjedhore, në momentin që janë bërë deklaramet nuk kanë qenë të qartë se si duhet ta deklaroinin pasi janë vendosur nga simpatizantët e kandidatit.
- Lidhur me shumën 140.000 lekë nuk është marrë cash, por është arkëtuar e dokumentuar me mandat arkëtimi e ndarë në këste nga kandidati për llogari të partisë Demokratike.
- Lidhur me shpenzimet e bëra nga kandidati për deputet, z. Arben Tafaj, në faqen në Facebook, nuk janë deklaruar pasi nuk ishin marrë dokumentat bazë ligjore dhe kontabël justifikuese nga z. Arben Tafaj. Kandidati i ka bërë këto shpenzime nëpërmjet kartës së tij bankare.
- Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve, PAA ka qenë me status pasiv në sistemin

informativ tatimor dhe nuk ka pasur marrëdhënie me të tretë dhe nuk janë kryer transaksione.

8. Partia SocialDemokrate e Shqipërisë

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 16 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *nuk janë deklaruar prej partisë kryerja e pagesave për reklamë politike në Facebook dhe Instagram;*
- *5 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Edhe pse të gjithë kandidatët janë informuar lidhur me detyrimet që u burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, në përfundim të procesit zgjedhor asnjë kandidat nuk ka dorëzuar raportet financiare pranë subjektit zgjedhor.

9. Partia Balli Kombëtar Demokrat

Konstatimet e KRIIK

- *partia ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por në raportin e vetëdeklarimit ka deklaruar 0 shpenzime në këtë zë;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Partia nuk ka kryer shpenzime në facebook dhe instagram. Shpenzimet e Facebook-ut janë thjesht shpenzime personale të kandidatit për deputet, pra individuale dhe jo të partisë. Ndërsa në Instagram ka 0 shpenzime edhe për kandidatin për deputet. Këto shpenzime janë të papërfillshme duke qenë se janë 2 herë më pak se 100.000 lekë, pra këto janë dhe arsytet se pse nuk janë deklaruar.
- Bilanci i aseteve dhe detyrimeve sepse partia nuk ka pasur asete.

10. Partia Nisma Thurje:

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 4 zyrash zgjedhore të padeklaruar;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti; gjobe – 171 pika 1 ose 172 pika 2b*
- *10 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Përsa i përket zyrave zgjedhore, mënyra e funksionimit për zgjedhjet e vitit 2021, partia nuk ka pasur zyra të mirëfillta, të marra me qera apo në përdorim, por ka përdorur ambiente publike ku u realizonin meet-ups (takime të grupit). Zakonisht këto ambiente kanë qenë lokale publike, në të cilat realizoheshin takimet rutinë të stafit duke shfrytëzuar ambientin përkatës. Në disa raste zotëruesit e këtyre ambienteve pranonin të vendosnin edhe postera apo mjete të tjera promovionale.
- Në lidhje me shpenzimet në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, vërejnë një mospërputhje në shpërndarje mes shpenzimeve reale të kryera dhe shpenzimeve të evidentuara nga KRIIK.
- Përsa i përket bilancit të aseteve PNTH është regjistruar në Gjykatë në datën 31.01.2021 dhe regjistrimin në tatime e ka bërë në fund të muajit Shkurt 2021, pra nuk ka pasur aktivitete të mëhershme ekonomike përveç aktiviteteve të kryera dhe raportuara në fushatën zgjedhore.

11. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 4 zyrash zgjedhore të padeklaruar;*
- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve*

Përgjigja

- Kandidati, z. Blerdi Liçaj, e ka deklaruar shpenzimin për reklamat politike në Facebook dhe Instagram për këtë arsye kanë dërguar raportin e faturave të Facebooku-ut nga data 01/02/2021-27/04/2021 bashkëlidhur email-it që ka dërguar.
- Partia ka raportuar të gjitha zyrat zgjedhore së bashku me kandidatët. Përsa i përket gjetjeve të dërguara nga KRIIK sqarojnë se mund të jenë postera të vendosura në ambiente private por që nuk kanë shërbyer si zyra zgjedhore.
- Asetet e LSI nuk kanë pasur as shtesa dhe as pakësime gjatë periudhës zgjedhore. LSI nuk ka pasuri të paluajtshme në pronësi. Asetet e LSI janë vetëm paisje zyrash dhe mjete transporti, të cilat raportohen dhe auditohen çdo vit nga ekspertët e auditit.

12. Partia Lëvizja për Ndryshim

Konstatimet e KRIIK

- *partia ka deklaruar pranimin e 4 dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *3 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Përgjigja

- Përsa i përket pranimit të 4 dhurimeve me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë me datë 12.04.2021 paratë janë derdhur në llogarinë bankare të partisë Lëvizja për Ndryshim së bashku me identitetin e dhuruesve dhe deklaratave të dhurimit
- Lidhur me shpenzimet për reklamat politike në Facebook dhe Instagram, në raportin e dërguar më datë 07.09.2021 protokolluar me tuajen me nr.6351 mbi shpenzimet për fushatën zgjedhore, në seksionin “2.c” “Te ardhurara, dhurime në natyrë” raportohen shpenzimet e kryera ne Facebook, konkretisht nga kandidatja Jozefina Topalli. Shpenzimet mbi reklama në facebook janë raportuar si të ardhura në natyrë për partinë (se bashku me vlerën përkatëse). Gjithashtu kandidatët kanë dorëzuar raportet e tyre përkatëse me datë 07.09.2021, protokolluar me tuajën me nr 6351/1
- Përsa i përket bilancit të aseteve theksojmë se partia “Lëvizja për Ndryshim” është regjistruar në regjistrin e partive politike me vendimin e gjykatës së rrethit tiranë nr.5 të

datës 23.11.2020, i cili ka hyrë në fuqi me datë 10.12.2020. Rrjedhimisht gjatë vitit 2020 partia “Lëvizja për Ndryshim” nuk ka pasur veprimtari financiare në të ardhura apo shpenzime. Më pas përgjatë vitit 2021 partia “Lëvizja për Ndryshim” ka dorëzuar në KQZ raportin mbi të ardhurat dhe shpenzimet për zgjedhjet e datës 25.04.2021, me datë 07.09.2021 protokolluar me tuajën me nr.6351 sipas përcaktimeve ligjore dhe raportin e shpenzimeve për vitin 2021 me datë 23.03.2022 protokolluar me tuajën me nr. 1857 sipas përcaktimeve ligjore.

13. Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila nëpërmjet telefonit sqaroi se ajo i ka dorëzuar njëherë informacionet e kërkuara.

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 8 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *4 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *32 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

14. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit, z. Elton Debreshi

Konstatimet e KRIIK

- *kandidati ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*

z. Debreshi më anë të email-it I ka vënë në dispozicion KQZ faturat e paguara për shpenzimet reklamav politike në rrjetin social Facebook.

Subjektet zgjedhore që nuk kanë kthyer përgjigje:

1. Partia Demokratike

Konstatimet e KRIIK

- *evidentohet një numër prej 190 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*

- 28 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;
- 23 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;
- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

2. Partia Aleanca Demokracia e Re

Konstatimet e KRIIK

- evidentohet një numër prej 2 zyrash zgjedhore të padeklaruara;
- 2 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;
- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

3. Partia Lëvizja Demokratike

Konstatimet e KRIIK

- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

4. Partia Emigracioni Shqiptar

Konstatimet e KRIIK

- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

Për subjektet zgjedhore:

1. Partia Kombëtare Konservatore Albania

Konstatimet e KRIIK

- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *raporti i dorëzuar nuk është në formatin e miratuar nga KQZ;*
- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

Për sa më sipër nga konstatimet e KRIIK, përgjigjet e dorëzuara nga subjektet zgjedhore si dhe verifikimet e bëra nga KQZ rezultojnë:

- Lidhur me zyrat zgjedhore tipologjia e informacionit të përcjell nga KRIIK është informacion i cili duhet vlerësuar / verifikuar në kohë reale, gjatë zhvillimit të fushatës. Në këtë fazë është i pamundur verifikimi i saktë në terren për të konstatuar informacionin e saktë për shkak se partitë politike pretendojnë tjetër numër në raport me numrin e zyrave që ka konstatuar KRIIK. Partitë politike pretendojnë se numrin e saktë për zyra zgjedhore të paguara / dhuruara nga ato e kanë paraqitur në raportin financiar të dorëzuar në KQZ. Në këto kushte KQZ nuk mund të provojë pretendimet e parashtruara nga palët.
- Lidhur me dorëzimin e bilancit të aseteve, pjesa më e madhe e subjekteve zgjedhore i kanë sjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pas njoftimit që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar duke qenë se ky informacion mungonte tek raportet e dorëzuara.
- Gjithashtu rezultojnë se kandidati i partisë politike “Lëvizja e Re”, z. Fitimtar Lala, ka pranuar dhurime me para në dorë në shumë më të madhe se 50 mijë lekë, përkatësisht një dhurim me shumën 141.000 lekë dhe një dhurim në shumën 54.000 lekë. Referuar nenit 173, pika 5 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... “Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së”.
- Financieri i partisë politike “Partia Bindja Demokratike”, z. Elton Ciko ka qenë njëkohësisht dhe kandidat i listave shumëmemërore në qarkun Tiranë.
- Financieri i partisë politike “Partia Emigracioni Shqiptar”, zj. Enkeleda Latifi, ka qenë njëkohësisht dhe kandidate e listave shumëmemërore në qarkun Elbasan.
- Financieri i partisë politike “Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare”, zj. Marcela Lala, ka qenë njëkohësisht dhe kandidate e listave shumëmemërore në qarkun Fier.

- Financieri i partisë politike "Partia Kombëtare Konservatore Albania, z. Rozher Prifti, ka qenë njëkohësisht dhe kandidat i listave shumemërore në qarkun Korçë.